



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i Lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Parapake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 6 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim Përmbledhës mbi Kërkesat për Zgjatje Afati

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup
Krasniqit**
Venkateswari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullës 9 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), jep këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin në lidhje me Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës (“Vendimi i 22 korrikut 2021”).²

2. Më 27 gusht 2021, ekipet e Mbrojtjes së zotërinjve Selimi, Krasniqi dhe Thaçi kërkuan autorizim për apelimin e Vendimit të 22 korrikut (“Kërkesat për Autorizim”).³

3. Më 31 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori Vendimin mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe për Shkelje të Pretenduara të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve (“Vendimi i 31 gushtit 2021”).⁴

4. Më 2 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) parashtroi një kërkesë për zgjatjen e afatit për t’iu përgjigjur Kërkesave për Autorizim deri më

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës* (“Vendimi i 22 korrikut 2021”), 22 korrik 2021, konfidencial. Një version i redaktuar publik u nxor në të njëjtën ditë, F00413/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00445, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes për Autorizim për Apelimin e Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 27 gusht 2021, publik; F00446, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesa e Mbrojtjes së Krasniqit për Autorizim për Apelimin e “Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës”*, 27 gusht 2021, publik; F00447, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për Autorizim për Apelimin e “Vendimit mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës”*, 27 gusht 2021, publik (“Kërkesa për Autorizim”).

⁴ KSC-BC-2020-06, F00450, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë e DH-së dhe ZPS-së dhe për Shkelje të Pretenduara të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve* (“Vendim i 31 gushtit 2021”), 31 gusht 2021 (njoftuar më 1 shtator 2021), publik.

30 shtator 2021 ("Kërkesa e ZPS-së").⁵ Ajo parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e kërkuar, duke pasur parasysh: (i) kohën që ekipet e Mbrojtjes kishin për të përgatitur Kërkesat për Autorizim, (ii) numrin e Kërkesave për Autorizim; (iii) numrin e pikave të ngritura (konkretisht 32); (iv) karakterin e hollësishëm dhe kompleksitetin e pikave të ngritura; dhe (v) shkallën e kufizuar të përkimit të pikave të ngritura.⁶

5. Më 2 shtator 2021, Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit") dorëzoi një kërkesë për zgjatjen e afatit për të kërkuar autorizim për apelimin e Vendimit të 31 gushtit 2021, deri më 17 shtator 2021 ("Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit").⁷ Ajo parashtron se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e kërkuar të afatit duke pasur parasysh: (i) karakterin kompleks dhe risinë e pikave të shqyrtuara në Vendimin e 31 gushtit 2021; (ii) nevojën për të kërkuar udhëzime efikase dhe konsultuar brenda për brenda nëse disa kundërshtime duhen paraqitur në apel; dhe (iii) faktin se ndryshimi i kërkuar është i arsyeshëm dhe i kufizuar.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *proprio motu* ose nëse i tregohen se ekzistojnë arsye të vlefshme, mund të shkurtojë çdo afat të parashikuar nga Rregullorja ose të vendosur nga trupi gjykues.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00451, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati për t'iu Përgjigjur Autorizimit për Apelimin e Kërkesave mbi Vendimin KSC-BC-2020-06/F00413* ("Kërkesa e ZPS-së"), 2 shtator 2021, publik, para. 2.

⁶ Kërkesa e ZPS-së, para. 2, poshtëshënimi 6.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00452, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit për Zgjatjen e Afatit për Autorizimin e Apelit të "Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe për Shkelje të Pretenduara të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve"*, ("Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit"), 2 shtator 2021 (njoftuar më 3 shtator 2021), publik, para. 3, 8.

⁸ Kërkesa e Mbrojtjes së Thaçit, para. 4-7.

7. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve mund të merret edhe pa i dhënë palës kundërshtare mundësinë për të shprehur mendimin.

III. DISKUTIM

8. Pasi shqyrtoi arsyet e parashtruara nga ZPS-ja, në veçanti, zgjatjen e afatit miratuar për ekipet e Mbrojtjes për parashtrimin e Kërkesave për Autorizim,⁹ numrin e Kërkesave për Autorizim dhe pikave të ngritura dhe karakterin e hollësishëm dhe kompleksitetin e këtyre pikave, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë demonstruar arsye të vlefshme të cilat bëjnë të nevojshme zgjatjen e kërkuar të afatit.

9. Për më tepër, pasi ka marrë parasysh arsyet e parashtruara nga Mbrojtja e Thaçit, në veçanti, kompleksitetin dhe risinë e pikave të shqyrtuara në Vendimin e 31 gushtit 2021 dhe rrjedhimisht kohën që kërkohet për përcaktimin e strategjisë së Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se janë paraqitur arsye të vlefshme të cilat bëjnë të domosdoshme zgjatjen e afatit. Për të njëjtat arsye dhe duke marrë parasysh nevojën për mbajtur një kalendar konsekuent për parashtrime, Gjykatësi i Procedurës Paraprake *proprio motu* miraton të njëjtën zgjatje afati për ekipet përkatëse të tjera të Mbrojtjes në çështjen aktuale në rast se ata kërkojnë autorizim për apelimin e Vendimit të 31 gushtit 2021.

10. Duke pasur parasysh se ndryshimet e kërkuara janë mjaft të kufizuara dhe duke vërejtur afatet e afërme të ZPS-së për t'iu përgjigjur Kërkesave për Autorizim dhe të Mbrojtjes për të kërkuar autorizim për apelimin e Vendimit të 31 gushtit 2021, ekipeve të ndryshme të Mbrojtjes, ZPS-së apo Mbrojtësit të Viktimave nuk u shkaktohet asnjë dëm me nxjerrjen e vendimit aktual përpara marrjes së përgjigjeve të tyre lidhur me Kërkesën e ZPS-së dhe/ose Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit, sipas rastit, në pajtim me rregullën 9(6) të Rregullores.

⁹ Vendimi i 22 korrikut 2021, para. 178, 179(g).

VENDIM

11. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së dhe **URDHËRON** ZPS-në t'u përgjigjet Kërkesave për Autorizim jo më vonë se **të enjten, 30 shtator 2021**;
- (b) **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të kërkojë autorizim për apelimin e Vendimit të 31 gushtit jo më vonë se **të premten, 17 shtator 2021**; dhe
- (c) **URDHËRON**, *proprio motu*, ekipet përkatëse të tjera Mbrojtjes të kërkojnë autorizim për apelimin e Vendimit të 31 gushtit 2021, jo më vonë se **të premten, 17 shtator 2021** në rast se dëshirojnë.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E hënë, 6 shtator 2021

Hagë, Holandë.